



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 690 Prot.

Tiranë, më 18/4 /2017

VENDIM
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 65, datë 18/4 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. _____, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 1327 Prot. datë 23.11.2016 ndaj Autoritetit Publik “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me datë 12.10.2016 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesat për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

Në lidhje me shkresën nr.160/16prot:

1. Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;
2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
3. Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në lidhje me shkresën nr.161/16prot:

1. Kopje të strukturës organizative;

2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;
3. Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;
4. Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.

Në lidhje me shkresën nr.162/16prot:

1. Kopje të planeve strategjike të punës;
2. Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;
3. Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;
4. Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;
5. Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;
6. Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;
7. Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
8. Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Në lidhje me shkresën nr.163/16prot:

1. Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;
2. Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarës me shkresën nr. 1313 Prot., datë 25.10.2016 duke u shprehur se informacioni i kërkuar është i publikuar në portalin e gjykatave, në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu Autoriteti Publik i ka vënë në dispozicion kërkuarës adresën e postës elektronike të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit duke e ftuar që të adresojë aty çdo kërkesë për informim.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1327 datë 23.11.2016 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri me shkresën nr. 1327/1 Prot., datë 01.12.2016 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 08.12.2016.

Autoriteti Publik është përgjigjur me shkresën nr. 3629 Prot., datë 06.12.2016 me anë të së cilës ka sqaruar pozicionin e tij në këtë çështje si dhe i ka vënë në dispozicion Komisionerit bashkëlidhur korrespondencën e shkëmbyer me kërkuarës, ku rezulton se këtij të fundit i është dërguar linku me informacionin e kërkuar në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në këtë shkresë Autoriteti Publik shpreh gjithashtu gadishmërinë për ta dërguar informacionin e kërkuar në çdo formë që kërkohet apo konsiderohet e nevojshme nga Komisioneri.

Nga administrimi i provave më sipër, si dhe monitorimi i faqes elektronike zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ku rezultoi i publikuar Programi i Transparencës, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 7, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare informacionin e kërkuar, i cili përfshihet në kategoritë e informacionit që vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë, si dhe i është përgjigjur kërkuarit lidhur me informacionin e kërkuar në përputhje me nenet 14 dhe 16 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

Sa më sipër, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioneri vlerëson se ajo është e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 1327 Prot., datë 23.11.2016 të Qendrës “Res Publica”, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës”.
2. Kundër këtij vendimi, ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot me datë 16. 4 .2017.

